

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë "GMK Auditing" Shpk

Sot, në Tiranë, më 01/02/2019, unë ortakia e vetme Sose Lamçe Shqiponja, hartoj Aktin e Themelimit të shoqërisë "GMK Auditing" shpk. sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, me dispozitat që vijojnë:

Neni 1 **Themelimi**

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkangjitet këtij Akti Themelues.

- 1) Emri i shoqërisë është "GMK Auditing" shpk. (këtu më poshtë e quajtur "Shoqëria"). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.

Neni 2 **Selia**

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: *Tiranë, Njësia Administrative nr.11, Sheshi "Karl Topia", Kulla Nr.1, Shkalla 3, Apartamenti 8.*
- 2) Shoqëria mund të themelojë degë në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3 **Objekti**

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- 1) Auditimin ligjor të pasqyrave financiare, shërbime kontabiliteti, shërbime të tjera të sigurisë dhe shërbime të lidhura sipas përcaktimeve të bëra për to nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve kur janë në pajtim me natyrën e profesionit dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi, konsulencë në fushën ekonomike, organizative, administrative, kontabël dhe fiskale, kurse trajnimi dhe formimi profesional, si edhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të

Tiranë, Njësia Administrative nr.11, Sheshi "Karl Topia", Kulla Nr.1, Shkalla 3, Apartamenti 8.
Email: gmkstudio@hotmail.com



konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimeve te biznesit e qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi.

Neni 4
Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 5
Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetgm

- 1) Kapitali themeltar i shoqerise do te jete i perbere nga kontributi i ortakut themelues te kesaj Shoqerie, ne vleren 100.000,00(njeqint mije) Leke, i perbere nga 1(nje) pjese me vlere nominale te nje pjese prej 100.000,00 (njeqint mije) lekesh.
- 2) Ortakia e Shoqerise eshte **Znj.Sose Shqiponja**, atesia **Lamce, e dtl. 06/02/1967** lindur ne **Kukur, Gramsh** dhe banues ne **Tirane** identifikuar nga karta e identitetit me **nr. 025167600**.

Neni 6
Ortaket

Ortaku i netem eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise.

Neni 7 Organet
Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", organet drejtuese te shoqerise jane si me poshte vijon:

- 1) Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve - organi me i larte vendimmarres;
- 2) Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqerise.

Menyra e organizimit te tyre dhe funksionimit eshte e percaktuar ne Statutin e Shoqerise qe i bashkelidhet ketij akti.

Shoqeria do te administrohet nga Administrator)a, **Znj.Sose Shqiponja**, atesia **Lamce, e dtl. 06/02/1967** lindur ne **Kukur , Gramsh** dhe banues ne **Tirane** identifikuar nga karta e identitetit me **nr. 025167600**, e cilit zgjidhet per 5 vjet.

Shoqeria perfaqesohet para cdo organi administrativ, gjyqesor, enti publik apo privat dhe ne marredhenie me te tretet nga administratori, i cili i ushtron keto te drejta ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.

NENI 8

Audituesit ligjorë

Audituesit ligjorë të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë Audituesin Ligjor.

NENI 9 **Pjesmarria**

Ortaku themelues mund të vendos me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10 **Ngritja e degëve apo filialeve**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11 **Ruajtja e Sekretit**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë, të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

NENI 13 **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze të ligjit, një kopje për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe dy kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKUI VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“GMK Auditing” Shpk

Sose Shqiponja

